

Lajmet e Fundit: Durrës – Finalizohet me sukses operacioni policor i koduar "Multifunksional"



07/06/2022

Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Permission”

Operacioni, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje

Operacioni, i zhvilluar nga Forca e Posaçme "Shqiponja", në bashkëpunim me Komisariatën e Policisë Nr. 2

Qarkullonin me armë zjarri në automjet, vihen në pranga 2 shtetas. Njëri prej tyre kishte shkelur masën "Arrest në shtëpi".

Sekuestrohen një armë zjarri pistoletë, një krehër dhe municion luftarak.

Shërbimet e Forcës së Posaqme "Shqiponja", në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Nr. 2, në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje, bazarit dhe në informacionet e marra në rrugë operative, se në rrugën "Hasan Alla", po lëvizte një shtetas i armatosur, kanë organizuar punën dhe kanë finalizuar me sukses operacionin policor të koduar "Permission".

Si rezultat i këtij operacioni, u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasve:

– A. A., 21 vjeç, banues në Fier, për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyeshe dhe municionit" dhe "Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit";

-A. B., 21 vjeç, banues në Tiranë, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyeshe dhe municionit".

Gjatë kontrollit të mjetit me të cilin po qarkullonin këta shtetas, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri pistoletë, një krehër dhe municion luftarak.

Gjatë verifikimeve ka rezultuar se shtetasi A. A. kishte shkelur masën e sigurisë "Arrest në shtëpi", duke dalë jashtë banesës.


Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme procedurale.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

f Share

in Share



◀ Gledis Nano, gjatë vizitës disaditore në Uashington, zhvilloi një sërë takimesh të rëndësishme, me zyrtarë të lartë të agjencive ligjzbatuese në Amerikë

DVP Elbasan/Arrestohet në flagrancë 1 shtetas, shpallet në kërkim 1 tjetër, për vepra të ndryshme penale ►